



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLAADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
ZYRA E Kryeministrit - Ured Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER	
SEKTORI I Arkivës - Sektor Arkive - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Doku: Doc. No.	02
Nr. Doku: Doc. No.	2570
Nr. Fajese: Bl. Shënime: Bl. Pajose:	-4-
Data: Datum:	08/11/2022
Prishtinë/a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

Datë: 08/11/2022

Ref: 287/20222

Kryesuesi dhe Bashkë-kryesuesi i Këshillit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, në mbështetje të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/96, të datës 02.04.2019, duke marrë parasysh Rregulloren e Punës së Këshillit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, dhe me qëllim të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 dhe planit të Veprimit për zbatimin e saj, nxjerrin:

**V E N D I M**

**PËR THEMELIMIN E EKIPEVE TË PUNËS PËR KËSHILLIN PËR BASHKËPUNIM TË QEVERISË ME SHOQËRINË CIVILE**

1. Ekipet e punës themelohen me qëllimin për të siguruar zbatimin e mandatit të Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile (në tekstin e mëtejshëm, Këshillit), për të ndihmuar punën e tij dhe për të siguruar funksionimin efektiv të Këshillit.
2. Ekipet e punës do të përfshijnë në përbërjen e tyre anëtarë të Këshillit, një përfaqësues të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit, përfaqësues të institucioneve publike dhe OShC-ve dhe ekspertë të tjerë fushëveprimi i të cilëve përputhet me objektivat përkatëse strategjike.
3. Numri i anëtarëve të secilit ekipi punues, sipas nevojës, do të përcaktohet nga Këshilli, në bashkërendim me të gjithë hisedarët e tjerë relevantë.
4. Themelohen katër Ekipet e Punës (në tekstin e mëtejshëm, Ekipet) në kuadër të Këshillit, konkretisht nga një ekip për secilin objektiv të Strategjisë.
5. Ekipet mblidhen gjashtë (6) herë në vit, në takime të rregullta. Sipas nevojës, ato mund të mbajnë takime shtesë.
6. Gjatë punës Ekipet do t'u përmbahen rregullave dhe procedurave të parapara me Rregulloren e Punës së Këshillit.
7. Secili ekip përzgjedh Koordinatorin/en e tij, i/e cili/a do ta udhëheqë dhe koordinojnë punën e tij. Koordinatorët/et do të jenë përfaqësues nga OJQ-të anëtare të Këshillit.
8. Koordinatorin/ja e Ekipit:
  - 8.1. Përzgjidhet nga anëtarët e ekipit;
  - 8.2. Fton takimet e ekipit;
  - 8.3. Përfaqëson dhe menaxhon punën e ekipit;

- 8.4. Udhëheq aktivitetet e ekipit dhe anëtarëve të tij në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të ekipit, në kuadër të fushëveprimit të Këshillit;
  - 8.5. Propozon masa korrigjuese në rastet kur nuk zbatohen konkluzionet e Këshillit;
  - 8.6. Kujdeset për përgatitjen dhe dorëzimin në Këshill të planit vjetor të punës së ekipit;
  - 8.7. Informon Këshillin për punën e Ekipit.
9. Të gjitha ekipet në takimet e tyre raportojnë për të arriturat, sfidat, si dhe përgatisin një listë me detyrat dhe obligimet për periudhën e ardhshme. Këto i raportohen Këshillit përmes koordinatorëve të Ekipeve të punës në bashkëpunim me ZQM/ZKM dhe CiviKos-it.
  10. Me qëllim të mbarëvajtjes së punës së Ekipeve dhe efikasitetit të tyre, koordinatorët do të mbajnë evidencë për pjesëmarrjen dhe angazhimin e secilit prej anëtarëve të ekipeve të punës.
  11. Puna e ekipeve do të zhvillohet në bashkërendim dhe koordinim të plotë me Zyrën për Qeverisje të Mirë, Platformën CiviKos dhe anëtarët e ekipeve të punës.
  12. Koordinatori/ja e Ekipit, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, është përgjegjës/e të përgatisë procesverbale, raporte e dokumente të tjera të nevojshme për përmbushjen e mandatit të Këshillit, në përputhje me Rregulloren e Punës së tij, dhe që t'i raportojnë Këshillit, në takimet e rregullta të tij, për punën e ekipit.
  13. Sipas nevojës, ekipet mund të ftojnë të marrin pjesë në punën e tyre përfaqësues të tjerë të institucioneve, OSHC-ët e organizatave të huaja dhe persona që nuk janë anëtarë të Këshillit por që janë ekspertë të fushave relevante për fushëveprimin e ekipit përkatëses.
  14. Sekretariati i Këshillit mbështet ekipet në mbarëvajtjen e punës së tyre.
  15. Obligohen të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces për ofrimin e të dhënave të kërkuara nga Koordinatorët e ekipeve dhe Sekretariati i Këshillit.
  16. Ekipet, përmes Koordinatorëve, i propozojnë Këshillit marrjen e masave për zbatimin e planeve të punës dhe masave të tjera për përmbushjen e mandatit të Këshillit.
  17. Koordinatorët e Ekipeve të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrin pjesë në një takim të ekipit, janë të obliguar që, përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit, të njoftojnë ekipin dhe në kohë t'ia delegojnë udhëheqjen e takimit një anëtar tjetër të ekipit.
  18. Anëtarët e Këshillit nga OShC-të në mënyrë vullnetare mund të përcaktohen të jenë pjesë e ekipeve të punës, ata mund të jenë pjesë e më shumë se një ekipi.
  19. Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive të linjës obligohen të emërojnë një pjesëmarrës nga institucionet e tyre në ekipin përkatës, sipas relevancës.
  20. Anëtarët e Ekipit që nuk mund të marrin pjesë në takime mund të dorëzojnë me shkrim opinionet dhe propozimet e tyre për materialet në agjendën e takimit.
  21. Përfundimi i mandatit për pjesëmarrje në ekip bëhet për shkak të mungesës së paarsyeshme nga takimet e ekipeve për më shumë se tre takime të rregullta brenda vitit.

## Shtojcë: Përbërja e ekipeve të punës

Ekipi për Objektivin Strategjik I " Pjesëmarrja e shoqërisë civile në bërjen e politikave" ka këtë përbërje:

### Anëtarët e ekipit të parë:

- **Dren Puka, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), koordinator i ekipit të parë;**
- Valmira Rashiti - Rrjeti i Grave të Kosovës, anëtare;
- Sadri Rrmoku - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale- KLGI, anëtar;
- Jeton Krasniqi - Vizioni i Shekullit 21, anëtar;
- Aurela Kadriu - Initiative for Kosova Community, anëtare
- Trendeline Dreshaj - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, anëtare;
- Artan Çollaku - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit, anëtar;
- Alberita Hyseni - Zyra e Kryeministrit/Zyra Ligjore, anëtare;
- Ibadete Mehmeti - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Planifikim Strategjik, anëtare;
- Mirlinda Lushtaku - Zyra e Kryeministrit/Sekretariati Koordinues i Qeverisë, anëtare;
- Manushaqe Muçaj - MAPL/Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, anëtare;
- Bajram Kosumi - Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve, anëtar;
- Enver Haxhijaj - Ministria e Punëve të Brendshme/Instituti i Kosovës për Administratë Publike, anëtar;
- Saranda Kryeziu - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, anëtare;
- Ismet Cakiqi - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Komunikim Publik, anëtar;
- Ylli Bekaj - Zyra e Kryeministrit/Zyra e Administratës Qendrore, anëtar.

Ekipi për Objektivin Strategjik II "Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik" ka këtë përbërje:

### Anëtarët e Ekipit të dytë:

- **Avdyl Gashi - Qendra e Rinisë Drenas QRD, Koordinator i ekipit të dytë;**
- Ekrem Bajrami - Initiative for Kosova Community, anëtar;
- Alutrim Dermaku - General Youth Education of Kosovo-GYEK, anëtar;
- Lura Limani - Kosova Foundation for Open Society -KFOS, anëtare;
- Qendrim Hoxha - LDA Ballkan, anëtar;
- Aurela Kadriu - Initiative for Kosova Community, anëtare;
- Arianit Jashari - *Access, antëta;*
- Adile Shaqiri - Ministria e Financave Punës dhe Transfereve/Departamenti i Mirëqenies Sociale, anëtare;
- Florim Canolli - Zyra e Kryeministrit/Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim, anëtar;
- Trëndeline Dreshaj, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, anëtare;
- Alberita Hyseni - Zyra e Kryeministrit/Zyra Ligjore, anëtare;
- Saranda Kryeziu - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, anëtare;
- Vera Rexhepi - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Planifikim Strategjik, anëtare;
- Elmedina Bajgora - Ministria e Financave Punës dhe Transfereve/Departamenti Ligjor, anëtare;
- Qerim Berisha - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Buxhet edhe Financa, anëtar;
- Arben Musliu - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Komunikim Publik, anëtar;
- Lulzim Ahmeti- MINT/ Zyra për Komunikim Publik, anëtar;
- Manushaqe Muçaj,-MAPL/Departamenti për Integri, anëtare.

Ekipi për Objektivin Strategjik III "Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike" në këtë përbërje:

Anëtarët e ekipit të tretë:

- **Vlorian Molliqaj - Action for Mothers and Children, Koordinator i ekipit të tretë;**
- Alutrim Dermaku - General Youth Education of Kosovo-GYEK, anëtar;
- Ekrem Bajrami- Initiative for Kosova Community, anëtar;
- Jeton Krsaniqi - Vizioni i Shekullit 21, anëtar;
- Valmira Rashiti- Rrjeti i Grave të Kosovës, anëtare;
- Avdyl Gashi - Qendra e Rinisë Drenas QRD, anëtar;
- Qëndrim Hoxha - LDA Balkan, anëtar;
- Elmedina Bajgora - Ministria e Financave Punës dhe Transfereve/Departamenti Ligjor, anëtare;
- Adile Shaqiri - Ministria e Financave Punës dhe Transfereve/Departamenti i Mirëqenies Sociale, anëtare;
- Bajram Kosumi - Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve, anëtar;
- Vera Rexhepi - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Planifikim Strategjik, anëtare;
- Alberita Hyseni, - Zyra e Kryeministrit/Zyra Ligjore, anëtare;
- Saranda Kryeziu- Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë, anëtare.

Ekipi për Objektivin Strategjik IV " Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik" në këtë përbërje:

Anëtarët e ekipit të katërt:

- **Abetare Gojani, Ipko Foundation Koorditore e ekipit të katërt**
- Avdyl Gashi - Qendra e Rinisë Drenas QRD, anëtar;
- Xhevat Bajrami-Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit/ Departamenti i Rinisë, anëtar;
- Trëndeline Dreshaj - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, anëtare;
- Valbona Fetahu - Zyra e Kryeministrit/Zyra Ligjore, anëtare;
- Ismet Cakiqi - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Komunikim Publik, anëtar;
- Ibadete Mehmeti - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Planifikim Strategjik, anëtare;
- Ekrem Ahmeti - Zyra e Kryeministrit/Sekretariati Koordinues i Qeverisë, anëtar;
- Bajram Kosumi - Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve, anëtar.

**Arben Krasniqi**

Zv. Sekretar i Përgjithshëm  
Kryesues i Këshillit

**Donika Emini**

Platforma CiviKos  
Bashkë-Kryesuese e Këshillit

**Vendimi iu dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit;
- Platformës CiviKos;
- Koordinatorëve të ekipeve të punës së Këshillit;
- Anëtarëve të Këshillit;
- Anëtareve të Ekipeve;
- Arkivit të ZKM-së.